

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit N.N.SH "[C...]" me seli në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson "[P.P]" avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Vjollca Shyti për pagesën e borxhit në shumën e përgjithshme prej 418,912.80€, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurës të paraqitura kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.262/2014, të datës 27.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.11.2019, mori këtë:


A K T V E N D I M

APROVOHEN ankesat e paditësit N.N.SH."[C...]" dhe e të paditurës Komuna e Gjakovës, ndërsa **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.262/2014, të datës 27.02.2017, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike I.C.nr.262/2014, të datës 27.02.2017, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është është miratuar pjesërisht si e bazuar kerkesëpadia e paditësit N.N.SH."[C...]" me seli në Gjakovë, ashtu që detyrohet i padituri Komuna e Gjakovës – Gjakovë, që t ia paguaj borxhin në shumën prej 38,435.43€ në emër të kompensimit për punët e kryera ndertimore të mbetura si të pa paguara, me kamatë në lartësinë të cilën e aplikojnë bankat komerciale në Kosovë për deponimin e mjeteve financiare prej një viti, pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Nën pikën II të dispozitivit është refuzuar pjesërisht si e pa bazuar kerkesëpadia e paditësit edhe atë në pjesën me të cilën ka kerkuar që të detyrohet i padituri t ia paguaj shumën prej 60,726.30€ në emër të dëmit të pësuar nga ndërprejja e punimeve ndertimore në mënyrë të një anshme nga pala e paditur me kamatë ligjore prej 7% duke e llogaritur nga data 25.04.2014, e deri në pagesën definitive. Ndërsa në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit është detyruar i padituri t ia pagujë paditësit shumën prej 1,903.20€ në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi N.N.SH."[C...]" me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimin për shpenzimet e procedurës me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje



Ekonomike, I.C.nr.262/2014, të datës 27.02.2017 ta ndryshojë dhe ta aprovojë kerkesëpadinë e paditësit si të bazuar saj për këtë pjesës refuzuese si dhe ta aprovojë lartësinë e kamatës sipas precizimit të kerkesëpadisë ose lenda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, ndersa saj për këtë lartësisë së pjesës aprovuese aktgjykimin e shkallës së parë ta vertetojë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë edhe pala e paditur Komuna e Gjakovës – Gjakovë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale duke i propozuar Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën e të paditurës Komuna e Gjakovës – Gjakovë, në tërësi si të bazuar, ta ndryshoj Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.262/2014, të datës 27.02.2017, vetem në pikën 1 dhe 3 të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ashtu që të refuzohet në tërësi kerkesëpadia e paditësit N.N.SH.”[C...]” me seli në Gjakovë, si e pa bazuar si dhe të obligohet paditësi që të paditurës t ia kompensojë shpenzimet procedurale pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.


Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesat janë të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi N.N.SH.”[C...]” me seli në Gjakovë me datën 25.04.2014 ka paraqitur padi në gjykatë kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Gjakovë për kompensimin e borxhit. Në padi ndër të tjera ka theksuar së paditësi dhe i padituri kanë lidhur katër (4) kontrata të natyrës ndertimore: Kontrata për ndërtimin e pendës në fshatin ”[...]” i , Kontrata për ndërtimin e AMF në ”[...]”, Kontrata për ndërtimin e AMF në ”[...]” të ulët dhe Kontrata për ndërtimin e përmendores se dëshmoreve dhe martirëve në fshatin ”[...]”. Paditësi ka filluar kryejjen e punimeve dhe ka kryer një pjesë të tyre, por në ndër kohë i padituri ka bërë ndërprerjen e kontratave dhe ka mbetur borxh në shumën prej 418,648.97€. Duke i propozuar gjykatës që të marrë aktgjykim me të cilin do ta detyrojë të paditurin që t ia paguaj paditësit shumën prej 418,912.80€, me kamatë ligjore duke e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar I.C.nr.262/2014, të datës 27.02.2017 në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kerkesëpadinë e paditësit N.N.SH.”[C...]” me seli në Gjakovë në shumën prej 38,435.43€ në emër të kompensimit për punët e kryera ndertimore. Ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar pjesërisht si të pa bazuar kerkesëpadinë e paditësit që në emër të dëmit të pesuar nga ndërprerja e punimeve në mënyrë të një anshem t ia paguaj shumën prej 60,726.30€.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka konstatuar së paditësi dhe i padituri ka qenë në raport kontraktues nga katër (4) kontratat të lidhura me shkrim për kryejjen e punës ndertimore kontrata të natyrës ndertimore: Kontrata për ndërtimin e pendës në fshatin



"[...]"; Kontrata për ndërtimin e AMF në "[...]", Kontrata për ndërtimin e AMF në "[...]" dhe Kontrata për ndërtimin e përmendores së dëshmoreve dhe martirëve në fshatin "[...]". Në kontratat e lidhura paditësi si operator ekonomik ka marrë detyrimin e kryerjes së ndertimeve konform kontratave të lidhura dhe dokumenteve mbështëtes të tyre, ndërsa i padituri si autoritet kontraktues ka marrë detyrimin e pagesës së çmimit në emër të kryerjes së punimeve dhe përmbushjën e detyrimit tjera të parapara me kontrata, me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave dhe me dokumentet tjera përcjellse të kontratave. Nga provat e lendës dhe nga ekspertiza gjyqesore e ndërtimtarisë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së paditësi ka filluar me realizimin e punimeve në të katër projektet në projektin e parë kontrata për ndërtimin e përmendorës për deshmorët dhe martirët e fshatit "[...]" të Bogës paditësi ka kryer të gjitha punimet ashtu siç janë paraparë me kontratë dhe me projektin si pas të cilit janë ekzekutuar punimet, ndërsa në tri projektet e tjera sipas kontratave të lidhura paditësi ka filluar punimet dhe te njëjat i ka kryer në menyrë të pjesëshme, sepse nderkohë gjatë zhvillimit të punimeve i padituri ka urdheruar paditësin që të nderpres punimet në të tri objektet e filluara së ndertuari me arsyetimin së komuna nuk ka mjete financiare në dispozicion për vazhdimin e metejshëm të punimeve dhe si rezultat i kësaj urdheresë paditësi ka nderprerë punimet e të cilat punime nuk kanë vazhduar asnjë herë as nga paditësi as nga pala e tretë.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjyqesor të ndërtimtarisë, të dhënë në raportin e ekspertizës, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se, lidhur me kontratën e parë për ndërtimin e përmendorës për deshmorët dhe martirët e luftës e fshatit "[...]" të Bogës, paditësi ka kryer punimet sipas kontratës në lartësinë prej 19,293.70€, i padituri ka bërë pagesën në emër të këtij projekti vetëm në shumën prej 2,960.41€, dhe rrjedhimisht ka mbetur borxh në shumën prej 16,333.29€. Lidhur me kontratën për ndërtimin e pendës në fshatin "[...]" të Bogës paditësi ka kryer punimet në lartësinë prej 23,075.90€, i padituri ka paguar vetëm shumën prej 12,474.86€, ndërsa pas kalkulimit të depozitit ka mbetur borxh ndaj paditësit nga kjo kontratë në shumën prej 9,540.94€. Lidhur me kontratën për ndërtimin e AMF paditësi ka kryer punimet në lartësinë prej 11,265.75€, i padituri ka paguar shumën prej 4,985.15€, ashtu që ka mbetur borxh në shumën prej 6,280.60€. Lidhur me ndërtimin e AMF në fshatin "[...]" paditësi ka kryer punimet në lartësinë prej 11,265.75€, i padituri ka paguar shumën prej 4,986.15€ ashtu që ka mbetur borxh në shumën prej 6,280.60€. Prandaj borxhi i mbetur nga punimet e kryera nga të katër (4) projektet e kryera ndertimore rezulton së i padituri i ka mbetur borxh paditësit në shumën e përgjithshme prej 38,435.43€.

Gjykata pas shqyrtimit të dhënë në raportin e ekspertizës, ndëgjimit të ekspertit në seancën degjimore dhe të provave tjera të lendës ka ardhur në përfundim së ekspertiza gjyqesore përmbanë të dhena të sakta dhe të mbështetur në provat e lendës ashtu që i padituri i ka mbetur borxh paditësit në emër të punimeve të kryera në të katër (4) projekteve ndertimore shumën e përgjithshme prej 38,435.43€. Andaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së, e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve



ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar nuk është e qartë se për cilat punë ndërtimore është aprovuar kërkesëpadia e paditësit. Poashtu ka paqartësi lidhur me kamatën e aprovuar sepse në dispozitiv nuk përcaktohet data nga e cilla rrjedh kamata por vetëm është theksuar se kamata llogaritet nga data e parashtrimit të padisë pa e theksuar këtë datë. Padia nuk është pjesë përberëse e aktgjykimit dhe nuk përbën dokument përmbarues andaj nga ky formulim i dispozitivit nuk mund të caktohet data e rrjedhjes së kamatës. Kjo formë e formulimit të dispozitivit pa saktësim, e bën dispozitivin të paqartë të pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe njëkohësisht të paekzekutueshëm.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, por në mënyrë të njëanshme duke ia falur besimin me tepër deklarimeve të palëve se provave materiale, si dhe duke u bazuar në “mendimin dhe konstatimet e ekspertit të ndërtimtarisë” pa dhënë asnjë sqarim se pse ja ka falur besimin këtyre konstatimeve, ka vendosur si ne dispozitivin e aktgjykimit të atakuar. Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka marrë vendimin e atakuar, pa qartësuar plotësisht gjendjen.

Mos vërtetimi i vlefshmërisë së provave kontestuese, si prova të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, përbejnë shkelje të dispozitës së Nenit 183.1 të LPK-së, i cili përcakton se ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.

Poashtu aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje të dispozitës së Nenit 258.1 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së parë, në vet arsyetimin e aktgjykimit thekson se paditësi në seancën e datës 03.11.2016, (e cila nga procesverbali rezulton si seancë e shqyrtimit kryesor), e ka ndryshuar padinë respektivisht përveq borxhit kryesor tani ka kërkuar edhe shumën prej 60,726.30 €, për kompensimin e dëmit të pësuar nga ndërprerja e punimeve në mënyrë të njëanshme. Zmadhimi i kërkesëpadiës apo parashtrimi edhe i një kërkesë tjetër krahas asaj



ekzistuese, sipas Nenit 257.1, përbën ndryshim të padisë. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë pasi ka mbajtur seancën përgatitore, në seancën e shqyrtimit kryesor heshtazi ka lejuar ndryshimin e padisë pa pëlqimin e të paditurit (Neni 258.2 i LPK-së), dhe pa marrë fare aktvendim për lejimin e ndryshimit të padisë ka proceduar me çështjen sipas kërkesëpadisë së ndryshuar dhe ka vendosur edhe për pjesën e ndryshuar me aktgjykim, pa i shqyrtuar provat dhe pa e vertetuar gjendjen faktike dhe bazueshmërinë juridike lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë. Prandaj një aktgjykim i tillë është plotësisht kontradiktor sepse gjykata fillimisht është dashur të marrë pëlqimin e të paditurit për ndryshimin e padisë dhe pastaj të vendos me aktvendim lidhur me ndryshimin e padisë. Në këtë rast nëse gjykata nuk lejon ndryshimin e padisë nuk e shqyrton fare dhe nuk vendos për atë kërkesë ndërsa nëse lejon ndryshimin atëherë duhet të administrojë provat dhe ta vërtetojë plotësisht gjendjen faktike për tërë kërkesëpadinë e ndryshuar e jo ashtu siq ka vepruar në rastin konkret duke shqyrtuar tërë kërkesëpadinë përfshirë edhe kërkesën tjetër krahas asaj ekzistuese por duke vlerësuar gjendjen faktike vetëm për kërkesën fillestare ndërsa në fund ka vendosur edhe për pjesën e pashqyrtuar dhe të njejtën e ka refuzuar, me arsyetim se paditësi nuk ka ofruar asnjë prove edhe pse barra e të provuarit bie mbi te.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktgjykim i atakuar doemos është dashur të prishet

Në ri-procedurë gjykata e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, në atë mënyrë që paraprakisht të qartësojë kërkesëpadinë e paditësit, të evitojë kundërtëhëniet ekzistuese në mes dispozitivit me arsyetimin, arsyetimit me faktet vendimtare dhe me arsyet e theksuara për çështjet kryesore dhe sipas nevojës të nxjerrë provat e nevojshme për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pas kësaj të merret vendim i ligjshëm dhe i drejtë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën c) të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ae.nr.101/2017, dt.18.11.2019

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli,d.v.

SAKTËSINË E KOPJES E VËRTETON
UDHËHEQËSI I SHKRIMORES SË GJYKATËS
Mahir Tutuli
TACNOST KOPIJE POTVRDUJE
RUKOVODI OC SUDSKE PISARNICE

